



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 56 dt.09.05.1995

**MBI PERCAKTIMIN E SHESHIT TE NDERTIMIT TE VEPRES  
MONUMENTALE PER VIKTIMAT E DIKTATURES KOMUNISTE**

Këshilli Bashkiak i Qytetit të Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Seksionit të Kulturës mbi përcaktimin e sheshit të ndërtimit të veprës monumentale kushtuar viktimave të diktaturës komuniste, mbështetur në Ligjin Nr.7491, dt.29.04.1991, neni.14, pika.15.

**VENDOSI**

1. Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve ti miratohet si shesh për Monumentin VIKTIMAT E DIKTATURES KOMUNISTE, Sheshi që krijohet nga kryqëzimi i Rrugës “Skënderbej” (rruga e bllokut të ambasadave) me Rrugën e “Durrësit”.
2. Për problemet që dalin nga vendosja e disa kioskave ngarkohet ti zgjidh Seksioni i Urbanistikës Ligjore.
3. Një kopje e vendimit ti dërgohet Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**